



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:907462  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05670783

**C.nr.1273/21**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ Departamenti Përgjithshëm Dvizioni Civil**, si gjykatë e shkallës së parë kontestimore, gjyqtari Burim Emërllahu, në lëndën kontestimore të paditësit H.K. „nga F.i,Rr”....., të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson avokati Bekim Sylejmani nga Ferizaji, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, me seli në Prishtinë , të cilën e përfaqësonë Veton Bublaku ,jurist pranë të paditurës ,baza e kontestit kompenzimi i shpenzimeve mjekësore ,e pas mbajtjes së seancës kryesore më dt. 27.03.2024 mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkespadija e paditësit H.K. nga F...dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë që paditësit H.K. të i’a paguaj shumë e të hollave prej 5500euro,në emër të shpenzimeve mjekësore të shkaktuara në periudhën kohore 28.11.2013 deri me datën 03.12.2013 ,për shkak të qëndrimit në Klinikën .... Spitali Akademik i .... RF e Gj.me kamatë prej 8 % në vit ,duke filluar nga dita e ushtrimit të padis 16.06.2014 e deri në pagesën definitive,të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

**II.Detyrohet** e paditura Kompania e Sigurimeve”E.”,në Prishtinë që paditësit H.K.,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën e të hollave prej 712.4 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditësi H.K. ka parashtruar padi në këtë gjykatë,kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve”E.”,në Prishtinë,me bazë juridike kompenzimi i shpenzimeve mjekësore.

Paditësi në padi ka deklaruar:paditësi me datë 27.11.2013 ka udhëtuar për në shtetin e Gj. përkatësisht në Sh....të Gj. dhe të nesërmen pasi kam arritur atje përkatësisht me datë 28.11.2013 është shtrirë në spitalin “....” i cili evidentohet me nr. të konsumatorit ..., pasi që kam pësuar një infeksion, e që si pasojë më është bllokuar tërësisht pjesa e djathtë të trupit nga koka e deri tek këmbët. Unë për periudhën të cilën kam qenë atje kam gëzuar sigurim shëndëtesor nga Kompania .... dhe atë shfrytëzim 90 dite, koha brenda cilit mund të shfrytëzohet 25.10.2013 deri më 25.10.2014 në ditën e tij të dytë është shtrirë në spital paditësi, vajza e vëllaut të paditësit e ka kontaktuar

kompaninë e lartëcekur, në bazë të procedurës së cekur në policë, kur paditësi ka dorëzuar kërkesën për zhdëmtim në kompaninë e lartëcekur, kjo e fundit atë e kanë refuzuar pa dhënë ndonjë arsytim për shkaqet e refuzimit. Si rezultat i kësaj fatëkeqësie paditësi ka qëndruar në spital për disa ditë e që si pasojë e kësaj i janë krijuar shpenzime në vlerë të konsiderueshme prej 4.824,41€ si dhe që nga data 30.01.2014 spitali i ka vënë kamatën paditësit në vlerë prej 10% e që deri më tani më këtë kamatë vlera e pagesës ka kaluar 5.500€. Spitali në fillim kur paditësi ishte shtrirë atje e kishte pranuar policën e sigurimit dhe se e liron paditësin nga pagesat dhe ato ja dërgon kompanisë së lartëcekur, mirëpo pasi ajo ka refuzuar ta paguaj spitali pagesat pas një kohe të gjatë ja ka dërguar paditësit, duke ja llogaritur edhe kamatën prej 10%. Paditësit çdo ditë e vonuar e kësaj pagese do ti kushtoj me interes prej 10% duke pasur parasysh faktin se paditësi është i pa punë dhe nuk ka mundësi që ti paguaj shpenzimet e më pas të pres kompensim nga kompania dhe në rast se nuk e kryen këtë pagesë, egziston rreziku që shteti Gj... ti vëj sanksionet paditësit duke mos i dhënë më vizë, e që për paditësin kjo do të ishte fatale, nga shkak se ai atje shkon për të punuar ndonjë ditë me qëllim që të krijoj të ardhura për mbijetësen e tij andaj i lutemi gjykatës që kësaj lënde ti jap prioritetin dhe ta vendos sa më parë që është e mundur duke pasur parasysh pozitën e paditësit.

Përfaqësuesi i paditësit avokati Bekim Sylejmani, nga Ferizaji ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditësit të ia paguaj shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

E paditura Kompania e sigurimeve "E." në përgjegje në padi ka deklaruar: Në kuptim të nenit 395 të LPK të Republikës së Kosovës, bëjmë përgjegje në padi në afatin e paraparë ligjor në çështjen juridike të H.K. nga Ferizaj, kundër të paditurës, KS "E." Prishtinë. E paditura e konteston kërkesë padinë, si për nga baza ashtu për nga lartësia. Në bazë të LPK-së, gjykata është e obliguar që palës së paditur të ja dërgoj me padi edhe provat tjera, me të cilat prova do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e shkaktarit të aksidentit, po ashtu do të vërtetohet edhe lartësia e kërkesë padisë. E paditura në shkresat e lëndës në procedurë të rregullt ka trajtuar kërkesën për kompensim dëmit dhe në bazë të provave të prezentuara është konstatuar se në bazë të njoftimit të datës 10.12.2010 nga ana e "....." kërkesa për kompensim dëmi është refuzuar, me arsyetimin se në këtë rast nuk mund të mbulohen shpenzimet, fatëkeqësisht sepse sipas kushteve të sigurimit të nënshkruar nga pala paditëse nuk ka ndodhur asnjë rast i siguruar. Për këtë arsye nuk mund të paguajmë këtë dëm dhe i njejtë refuzohet. Kërkojm nga gjykata që ta refuzoj në tërsi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurës V.B. gjatë seancës ka deklaruar: e kontestojmë në tërësi kërkesë padinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe nga lartësia, sepse sipas raportit mjekësor të lëshuar nga ..... me nr. ...-MA, e që është përgjegjëse për trajtimin e dëmeve, nga policia e shëndetit për udhëtim, rezulton se paditësi ka pasur probleme shëndetësore para ekzistuese dhe për të njëjtat është trajtuar edhe para një viti para

pranimet në spital sipas raporteve mjekësore të cilat i kemi pasur në dispozicion. Padiësi në Gj... ka ardhur për kontroll dhe trajtim të sëmundjes para ekzistuese shenja dhe simptoma të përkeqësimit të padiësit ka pasur edhe para hyrjes në Gj...sa ka qëndruar në A...në bazë të kushteve të sigurimit të policës së shëndetit në udhëtim që ia dorëzova gjykatës me nr. ..., të cilën padiësi e ka poseduar e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në bazë të kushteve të bashkangjitura të sigurimit e të cilat janë të zbatueshme për të gjitha seksionet pika 16 për dëmet e shkaktuara nga defektet fizike, dobësitë, gjendjet shëndetësore kronike ose sëmundjet që kanë ekzistuar, deri ose më parë se data e hyrjes së personit të siguruar në këtë mbrojtje siguresi nuk do të paguaj për raste të tilla, e meqenëse në raportet mjekësore padiësi ka vuajtur nga sëmundja para ekzistuese i njëjti është i përjashtuar nga mbulesa siguresi sipas policës së lartë cekur.

Përfaqësuesi i mëparshëm i të paditurës I.B. kishte deklaruar: kam vërejtje për të gjitha raportet mjekësore, te spitalit Klinika "....." –Gj.....kurse në prova tjera nuk kam vërejtje.Mbetem në tërsi në thëniet e thëna në seancat e kaluara, dhe ato që janë thënë në seancën e kaluar, duke u bazuar në Policën e shëndetit në udhëtim me numër 44028836 të lëshuar nga KS "....." dhe duke u referuar kushteve të përgjithshme të sigurimit të shëndetit në udhëtim – përjashtime të zbatueshme për të gjitha seksionet pika 16 citoj: për dëmet e shkaktuara nga defektet : fizike dobësi, gjendja shëndetësore kronike ose sëmundje që kanë ekzistuar deri ose më parë se datës hyrës së personit të siguruar në këtë mbrojtje dhe në bazë të kësaj dispozite - Mondial assistance – resigures kërkesë për kompensim demi e ka refuzuar me arsyetim se me këtë rast nuk mund të mbulohen shpenzimet. Sipas kushteve të sigurimit të nënshkruar nga padiësi, nuk ka ndodhur asnjë rast i siguruar, dhe për të njëjtin kërkojmë nga gjykata që kërkesë padia e padiësit të refuzoj në tërsi duke u ndërglidhur edhe me dy prova tjera, sepse pacienti ishte më parë në spital në V.... dhe në bazë të shkresë për verifikim të punësimit të ....., padiësi ka punuar deri më 01 korrik 2014, si shofer i kamioneve të rëndë.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me leximin e Policës së Shëndetit në Udhëtim,nr.....,e datës 16.10.2013 gjykata ka vërtetuar se padiësi dhe e paditura kishin lidhur marrëveshje sipas së cilës marrëveshje padiësi ka paguar shumën prej 44.68 euro në të cilën hynë 38.52 euro primi i sigurimit dhe 6.16. euro TVSH,kurse e paditura ka pasur detyrim të kompenzoi shpenzimet mjekësore të padiësit që mund të shkatohen gjatë qëndrimit të tij jashtë territorit të Kosovës ,për periudhën kohore 90 ditore ,nga data 25.10.2013 deri me datë 25.10.2014.

Me leximin e faturës përfundimtare ,të datës 05.12.2013,gjykata ka vërtetuar se padiësit kishte bërë shpenzime mjekësore jashtë teritorit të Kosovës ,ashtu që me qëllim të përmirësimit të gjendjes së tij shëndetësore kishte qëndruar në Klinikën E.....Spitali Akademik i Universitetit T., në periudhën kohore prej 28.11.2013 deri më 03.12.2013,kurse fatura në fjalë i ishte drejtuar .... –... Kompania e Sigurimeve ,duke u bazuar në polisën e sipër përmendur ,me numër të sigurimit ....

Nga faktet jo kontestuese ndërmjet palëve rezulton se e paditura nuk ia ka kompenzuar paditësit shpenzimet mjekësore të bëra gjat qëndrimit të tij në klinikën e sipër përmendur.

Me leximin e vërejtjes së fundit të lëshuar nga Klinikum...,e datës 27.05.2014 gjykata ka vërtetuar se kjo klinik kishte kërkuar nga paditësi që të paguaj shumën prej 5510,57 euro në emër të shpenzimeve mjekësore dhe interesit që ka lidhje me këto shpenzime.

Nga përgjegjja në ankesë nr.../14 ,e datës 02.04.2014 ,nr.../14 ,e lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se paditësi kishte parashtruar kërkesë te e paditura për kompenzimin e shpenzimeve mjekësore në fjalë ,mirëpo e paditura e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompenzimin e shpenzimeve mjekësore.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjekësorë Dr.N.Gj. gjykata ka vërtetuar se smundja për të cilën paditësi iu ka nënshtruar trajtimit mjekësorë në periudhën kohore të sipër përmendur prej 28.11.2013 deri më 03.12.2013 në Klinikën E....n Spitali Akademik i Universitetit T.....,ka filluar me datën 28.11.2013, pra nga ky konstatim dhe mendim mjekësorë vërtetohet se se smundja për të cilën paditësi iu ka nënshtruar trajtimit mjekësorë në periudhën kohore të sipër përmendur prej 28.11.2013 deri më 03.12.2013 në Klinikën ..... Spitali Akademik i Universitetit T. nuk është smundje paraekzistuese.

Gjykata nuk ia ka falur besimin dokumentit me shënime .... Assistance ,raport mjekësorë i datës 10.06.2016 në cilin theksohet; se mbulimi shpenzimeve mjekësore nuk rekomandohet ,me arsyetim se paditësi në spitalin e sipër përmednur është nënshtruar kontrollit dhe trajtimit të smundjes paraekzistuese.Kurse arsyet në të cilat gjykata është bazuar me rastin e mos faljes së besimit të dokumentit në fjalë janë: Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjekësorë Dr.N.Sh. gjykata ka vërtetuar se smundja për të cilën paditësi iu ka nënshtruar trajtimit mjekësorë në periudhën kohore të sipër përmendur prej 28.11.2013 deri më 03.12.2013 në Klinikën E..... Spitali Akademik i Universitetit T., ka filluar me datën 28.11.2013,pra nga ky konstatim dhe mendim mjekësorë vërtetohet se se smundja për të cilën paditësi iu ka nënshtruar trajtimit mjekësorë në periudhën kohore të sipër përmendur prej 28.11.2013 deri më 03.12.2013 në Klinikën E. Spitali Akademik i Universitetit T.... nuk është smundje paraekzistuese.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe thënjet e paditëses e cila smundjen për të cilën paditësi ka marr trajtim mjekësorë e quan paraekzistuese ,mirëpo këtyre thënjeve gjykata nuk ua fali besimin sepse nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit N.Sh. vërtetohet se smundja për të cilën iu ka nënshtruar trajtimit mjekësorë paditësi nuk është smundje paraekzistuese.

Gjykata ka vlerësuar edhe fotokopjen e pasaportës së paditësit së dorëzuar nga e paditura si provë,mirëpo kjo gjykatë konsideron se një prove e tillë nuk mund të ketë ndikim në vendosjen e kësaj qështje, sepse nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit N.Sh.

vërtetohet se smundja për të cilën iu ka nëntruar trajtimin mjekësorë paditësi nuk është smundje paraekzistuese.

Gjykata bazuar në gjendjen faktike të sipër përmendur erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit me përmbajtje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi është e bazuar dhe të njëjten e ka aprovuar duke u bazuar parasegjithash në faktin se paditura në bazë të polisës nr...., të datës 16.10.2013 ka pasur detyrim të kompenzoi shpenzimet mjekësore të paditësit ,të bëra në periudhën kohore 28.11.2013 deri më 03.12.2013 në Klinikën E....vlera e të cilave së bashku me interesin që ka lidhje me këto shpenzime është 5510,57 euro.Kurse kjo gjykatë është bazuar edhe në nenin 8 paragrafi 1 i LMD-së së Kosovës,në lidhje me nenin 940 paragrafi 1 të LMD-së së Kosovës.

Kurse sa i përket kamatës në shkallë prej 8 % në vit nga dita e parashtrimit të padis gjykata është bazuar në nenin 382 të LMD-së së Kosovës .

Gjykata me qëllim të zbatimit të vërejtjeve të Gjykatës së Shkallës së dytë në seancën e dates 13.03.2024 i ka udhëzuar palët se mund propozojnë super ekspertizë nga lëmia e neuropsikiatrisë ose neurologjisë me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ,por palët përmes përfaqësuesve të tyre kanë deklaruar se nuk kanë propozim për super ekspertizë.

Gjykata bazuar në dispozitat e neneve 452.5 454.1,452.1 të LPK-së e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompenzoi shpenzimet e procedurës edhe atë:për tri seanca të mbajtuara 540.80 euro,për një seancë të shtyer 67.60 euro,për hartimin e padis 104 euro duke u bazuar sa i përket shpenzimeve për përfaqësim dhe hartimin e padis në tarifen e OAK-ut të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**Më datë 27.03.2024**

**Gjyqtari**  
Burim Emërllahu

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë ,në afat prej 15 ditësh ,nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.